



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Drejtoria për Arsim / Direkcija za Obrazovanje / Department of Education

Nr.Prot: 42/2025

Data: 20.02.2025

Në bazë të nenit 62 paragrafi 62.3 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 8 paragrafi 3 e nenparagrafi 3.1, neni 10 paragrafi 1 e nenparagrafi 1.2 të Rregullores QRK Nr: 19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar, neni 5 pikës c të Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës Nr.03/L-068, neni 35 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës si dhe në bazë të vendimit të Kryetarit të Komunës me Nr.02-111/01-0007263/25 i datës 20.02.2025, Drejtoria e Arsimit në Skenderaj shpall:

**KONKURS
PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS**

Nr	Niveli	Pozita	Vend i lirë/Zëvendësim	Numri i pozitave
1	IP	Edukatore për grupmoshën 0-3 vjeç	Kohë të pacaktuar	4
2	IP	Edukatore për grupmoshën 3-6 vjeç	Kohë të pacaktuar	5

I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit (merret në komunë – Qendra për Shërbime me Qytetarë – nr 13);
- Rezymeja personale (CV);
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë);
- Diplomat e kualifikimit, **duhet të jenë të vërtetuara ose noterizuara;**
- Certifikatat e noterizuara (certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë jo më të vjetra se gjashtë (6) muaj nga data e diplomimit;
- Certifikata që nuk jeni nën hetime;
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (**nëse ka**).

II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (**Ligji Nr. 02/L-52, Ligji Nr. 03/L-068 dhe Ligji Nr.**

04/L-138) dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës të **MASHTI-it (UA Nr. 05/2021)** si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

1. Kriteret e kualifikimit për Edukatore për grupmoshën 0-3 vjeç:

- Fakulteti i Edukimit - programi katërvjeçar i nivelit baçelor për edukimin në fëmijërinë e hershme 0-3 vjeç;
- Shkolla e mesme e mjekësisë – drejtimi infermiere – edukatore;
- Shkolla e mesme e mjekësisë – drejtimi i pediatriisë
- Shkolla e mesme e mjekësisë – drejtimi mami;
- Shkolla e mesme e mjekësisë së përgjithshme

2. Kriteret e kualifikimit për Edukatore për grupmoshën 3-6 vjeç:

- Fakulteti i Edukimit – programi katërvjeçar i niveelit baçelor për edukimin parashkollor;
- Shkolla e Lartë Pedagogjikë – drejtimi për edukatorë;
- Fakulteti Filozofik – dega e pedagogjisë së përgjithshme.

III. Vlerësimi i kandidatëve

- Me këtë konkurs do të zhvillohen procedurat e rekrutimit për IP e re;
- Kandidatët me kualifikime jo-përkatëse sipas ligjeve dhe UA të cekur në pikën II të këtij konkursi nuk do të merren në shqyrtim;
- Pas plotësimit të dispozitave ligjore dhe kriterëve të konkursit publik, kandidatët do t'i nënshtrohen testimit me shkrim. Testi me shkrim në maksimum tërheq 100 pikë apo deri në 50% të vlerësimit përfundimtar;
- Kandidatët që arrijnë së paku 50% të pikëve nga testi me shkrim, i nënshtrohen intervistimit me gojë. Në intervistën me gojë, kandidatët mund të vlerësohen në maksimum deri në 100 pikë apo 50% të vlerësimit përfundimtar;
- Vlerësimi në intervistimin me gojë bazohet në këto kriterë: Njohuritë e përgjithshme 25 pikë; Aftësitë e përgjithshme dhe personalitetit 35 pikë; Njohuritë profesionale 40 pikë;
- Pikët nga testi me shkrim dhe intervista me gojë mbliidhen në shumën e përgjithshme dhe kandidatët me më shumë pikë do të përzgjedhen në pozitat e lartpërmendura;
- Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për test me shkrim dhe intervistë me gojë, si dhe orari i intervistave publikohen në webfaqen e <https://kk.rks-gov.net/skenderaj/category/konkursej-njofitet/> (konkurset) dhe përmes telefonit.
- Rezultatet përfundimtare të vlerësimit do të shpallen në web-faqen zyrtare të Komunës të Skenderajt;

IV. Afati dhe mënyra e aplikimit

- Konkursi mbetet i hapur **30 ditë** nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit më: **21.02.2025** deri më datën **20.03.2025**.
- Aplikacioni merret dhe dorëzohet në objektin e komunës, kati i parë, sporteli Nr.13;
- Dokumentet e pakompletuara si dhe ato pas afatit, nuk merren në shqyrtim.
- Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen dhe duhet të jenë kopje, përveç diplomave të noterizuara;
- Kandidatët që kanë diplomuar jashtë Kosovës, duhet të kenë diplomat e nostrifikuara në MASHTI;
- Si informata të sakta dhe të vërteta, konsiderohen vetëm informatat që janë të dëshmuara me dokumente përkatëse (jo vetëm të deklaruara në aplikacion);
- Nëse aplikohet për dy pozita (Vend i lirë/Zëvendësim), kandidatët duhet të dorëzojnë dy aplikacione të veçanta;
- Kandidatët duhet të ruajnë dëshminë e aplikimit, e cila është e domosdoshme me rastin e shpalljes së rezultateve përkatëse;
- Rezultatet e konkursit do të shpallen në webfaqe të Komunës së Skenderajt.

Vërejtje: Të gjitha aplikacionet e pakompletuara, mosplotësimet e sakta dhe të qarta të formularit të aplikimit dhe ato që dorëzohen jashtë afatit zyrtar të përcaktuar në këtë konkurs nuk do të shqyrtohen.